



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0053
2023/0054

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani - Kryetar, Kimete Gashi - Anëtare, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Internat Security Association" SH.P.K., Rojet E Nderit SH.P.K., kundër /, / lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës” me numër të prokurimit 632-22-6005-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, KOMUNA E GJAKOVËS, më 18/05/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Anulohet** aktiviteti i prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës”, me numër të prokurimit 632-22-6005-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, KOMUNA E GJAKOVËS.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.
3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 27.01.2023, OE “Internat Security Association” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0053, ndërsa me datë : 30.01.2023, OE “Rojet E Nderit SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankese me nr: 2023/0054, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me

aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve te Komunës se Gjakovës” me nr. te prokurimit: "632-22-6005-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: , shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 340,000€. Konform nenit 113, 114 te Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues.

Për aktivitetin prokurimit në rastin konkret, AK me datë 12.01.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së me të cilin ka anuluar aktivitetin në tërësi me arsyetimin se të gjithë OE-të pjesëmarrës kanë tejkaluar vlerën e parashikuar.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 27 tetor 2022, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesat me nr 0053/2023 si dhe 0054/2023 të hudhen si të palejuara
- Të anulohet aktiviteti i prokurimit; Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesat e parashtruara si më sipër në raportin e tij ka deklaruar se:

Theksojmë se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që paga neto për një punëtor duhet të jetë jo më pak se 280€, ku njëkohësisht në paramasë kanë përcaktuar se duhet të jenë 38 punëtor, ndërsa kohëzgjatja e kontratës është 24 muaj. Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesave të dosjes së tenderit si dhe sqarimeve të kërkuara nga AK për analizë të cmimit dhe sqarimeve të ofruara nga OE ankues, mendimi i ekspertit shqyrtues është cmimi total prej 325.561.61€ pas pagesës së TVSH-së nuk arrinë të mbuloj pagat neto të punëtorëve.

Më tutje sqarojmë se sipas kalkulimeve tona vlera e parashikuar nga prej 340,000€ e bënë të pamundur realizimin e kësaj kontrate, për arsye se vlera minimale e nevojshme për të mbuluar vetëm pagat neto prej 280€ tejkalon shumën 344,000€.

Në këto rrethana cdo OE që ofron cmim edhe 100% sipas vlerës të parashikuar nga AK ose më të ulët nuk do të arrijë të mbuloj pagat e punëtorëve, ndërsa cdo OE që ofron cmim i cili mbulon pagat e punëtorëve prej 280€ neto do të tejkaloj vlerën e parashikuar nga AK dhe të njëjtit mund të eliminohen ashtu si ka vepruar AK me OE tjerë.

Vlerësojmë se planifikimi i këtij prokurimi dhe parashikimi i vlerës nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 17 par.1 të LPP-së dhe sipas mendimit tonë e bënë të pamundur të shpërblehet me kontratë cili do OE pavarësisht cmimit që ofron ai.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

- Konstatimet e Panelit shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, vlerëson se mbështetet në raportin e ekspertizës i cili rekomandon anulim të aktivitetit.

Ankesat në fjalë si objekt kontestues shqyrtimi kanë pasur pretendimet se eliminimi i tyre konsiston në mospërputhjen me vlerën e parashikuar, andaj duke qenë se pretendimet ankimore kanë ngjashmëri në kontestin e arsyeve të eliminimit, PSH konstaton se të dy ankesat do të trajtohen bashkërisht si dhe deri tek përcaktimi dhe vendosja përfundimtare lidhur me këtë aktivitet PSH ka arritur për faktin se dosja e përpiluar nga AK, përkatësisht kërkesat në të kanë qenë në kundërshtim me vlerën e parashikuar të kontratës, duke rezultuar që asnjë nga OE pjesëmarrës të jenë fitues potencial të kontratës relevante.

Paneli shqyrtues morri për bazë konstatimet e ekspertit se planifikimi i këtij prokurimi dhe parashikimi i vlerës nuk është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 17 par.1 të LPP-së që si rrjedhojë ka bërë të pamundur të shpërblehet me kontratë cili do OE pavarësisht çmimit që ofron ai, sepse po të ofertohej konform kërkesave të DT, atëherë kjo do të tejkalonte vlerën e parashikuar, ndërsa edhe ofertimi nën vlerën e parashikuar do të nënkuptonte që nuk do të mbuloheshin pagat dhe shpenzimet minimale të OE, andaj përfundimisht duke pasur parasysh të gjitha këto, PSH konstaton se AK nuk ka përpiluar dosjen e tenderit konform LPP-së, konkretisht nenit 17 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"1. Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguheshin nga autoriteti kontraktues sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për shërbime, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, detyrimet dhe tarifatat e tjera."*, ndërsa në të njëjtën kohë ka anuluar aktivitetin duke aplikuar nenin 62 të LPP-së për faktin se gjithë ofertat kanë tejkaluar vlerën e parashikuar.

Përfundimisht, PSH konstaton se në këtë rast AK nuk ka përpiluar DT konform dispozitave të LPP-së, si dhe me veprimet e ndërmarra ka rezultuar deri tek situata që është ardhur, andaj përmes këtij vendimi, PSH lëshon vërejtje përfundimtare ndaj ZPP të AK-së, që nëse në të ardhmen evidentohen lëshime/gabime të njëjta apo të ngjashme si këto, OSHP në kuadër të paneleve shqyrtuese do ti drejtohet KRPP-së, dhe do të kërkojë që të veprojë konform nenit 25, paragrafit 8 të LPP-së.

Vendimi si në pikën 3 të këtij vendimi u morr për faktin se anulimi i aktivitetit është bërë si pasojë e veprimeve dhe lëshimeve të AK-së.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS, KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - "Internat Security Association" SH.P.K., Rojet E Nderit SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: